REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:107120
Datë: 19.11.2020
Numri i dokumentit: 01283008

PKR.nr.165/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, Kryetar i trupit gjykues-gjyqtari Bekim Veliqi, me procesmbajtësin Endrit Hajrizaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit I.G nga ...-Maqedoni për veprën penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së*, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.4832/18 e dt.07.08.2019, e përfaqësuar nga Prokurori i Shtetit Naim Beka, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar ku ka prezentuar i akuzuari I.G, në bazë të nenit 359, 360, 361, 362, 365, 366 të KPP-së, me dt.17.11.2020, është marrë dhe shpallur publikisht aktgjykimi në prezencë të të akuzuarit ndërsa në mungesë të Prokurorit të Shtetit, ndërsa aktgjykimi është përpiluar me dt.19.11.2020:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:
I.G, nga i ati Z., e ëma Sh., e gjinisë F., i lindur me dt...., me vendbanim në rr."..." në ...-Maqedoni, me nr.letërnjoftimi ..., i pa martuar, Shqiptar, Shtetas i Maqedonisë.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me dt.11.11.2018, rreth orës 18:20 min., në afërsi të lokalit "E." në Shupkovc Komuna e Mitrovicës në veturën e tij kishte në posedim armën në kundërshim me nenin 4 par.1 pika 1.1 nën pika 1.1.2 të Ligjit për Armët (Ligji Nr.05/L -022), përkatësisht një bocë me sprej (OS) ngjyrë e gjelbërt, "American Style NATO" të cilën policia e sekuestroi.

Me këtë ka kryer veprën penale *Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.*

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 62, 69, 73 të KPRK-së dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366 të KPP-së:

S H Q I P T O N

I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 300€ (treqind euro), të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast së i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 46 të KPRK-së, në zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënim me burgim duke llogaritur 20€ (njëzet euro) për një ditë të kaluar në burg.

2019:186386

II. Gjykata në mbështetje të nenit 62 par.2 pika 2.7 lidhur me nenin 69 par.1 e 2 të KPRK-së, e lidhur me nenin 282 par.1 e 2 nën par.2.1 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton **DËNIM PLOTËSUES** Konfiskimi i sendit – një bocë me sprej (OS) ngjyrë e gjelbërt, "American Style NATO", pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi boca me sprej të shkatërrohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

III. Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 20€ (njëzet euro), paushallin gjyqësor në shumën prej 20€ (njëzet euro) si dhe 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të Fondit për kompenzimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka parashtruar Aktakuzën PP.II.nr.4832/18 e dt.07.08.2019, ndaj të akuzuarit I.G nga ...-Maqedoni, për veprën penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.*

Në këtë çështje penale është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar me dt.17.11.2020, në të cilën ka prezantuar Prokurori i Shtetit Naim Beka, i akuzuari I.G, ku janë ndërmarrë veprimet përkatëse juridike, seanca ka qenë e hapur dhe publike në respektim të masave anti Covid-19.

Gjatë kësaj seance të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar dhe njoftuar me të drejtat e tij konform nenit 246 par.1 të KPP-së, pas deklarimeve të të akuzuarit është vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, më pas i akuzuari është deklaruar se e kupton akuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe pas bindjes së kryetarit të trupit gjykues se i akuzuari e ka kuptuar akuzën, i është ofruar mundësia që të pranojë fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuari është deklaruar se e ndjen vetën fajtor për veprën penale me të cilën akuzohet, kam deklaruar edhe në polici se këtë mjet e kam pasur në rast se sulmohem për tu mbrojtur për arsye se në atë kohë kam punuar edhe ne ... kemi pasur biznesin tonë-burketore, kjo ka qenë hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin.

I akuzuari është njoftuar me pasojat e pranimit të fajësisë dhe rrethanat që i vlerëson gjykata në këtë çështje, duke e njoftuar se vepra penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së*, ligji përcakton se kryesi dënohet me gjobë deri në 7.500€ euro ose me dënim me burgim deri në 5 vjet, i akuzuari është njoftuar se në mbështetje të nenit 383 par.2 të KPP-së, në rast të pranimit të fajësisë nuk e ka të drejtën e parashtrimit të ankesës për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë gjendjes faktike, po ashtu është njoftuar se në këtë fazë të procedurës nuk prezentohen provat materiale dhe ato personale por ato vlerësohen në rastin e caktimit të dënimit dhe matjes së tij, pranimin e fajësisë gjykata e vlerëson si rrethanë lehtësuese.

I akuzuari ka deklaruar se i kupton pasojat e pranimit të fajësisë dhe rrethanat lehtësuese që i merr gjykata me rastin e matjes së dënimit dhe mbetet pas pranimit të fajësisë.

2019:186386

Në mbështetje të nenit 248 par.2 të KPP-së, është kërkuar mendimi i Prokurorit të Shtetit lidhur me deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili ka deklaruar se pranimi i fajësisë është i vullnetshëm plotësohen kriteret nga neni 248 i KPP-së pasi që është në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Pas marrjes së mendimit nga Prokurori i Shtetit, Kryetari trupit gjykues është bindur se i akuzuari e kupton natyrën e pranimit dhe pasojat e pranimit të fajësisë, andaj Kryetari i trupit gjykues në procesverbal në kuptim të nenit 248 par.4 e lidhur me par.1 nën par 1.1,1.2,1.3,1.4 të KPP-së, ka marrë aktvendim duke pranuar pranimin e fajësisë, pasi që i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale.

Pas pranimit të faësisë nga ana e gjykatës Prokurori i Shtetit ka deklaruar që gjykata t'i ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese me rastin e përcaktimit të dënimit.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e gjykatës, i akuzuari ka deklaruar se kjo ka qenë hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin, siç deklarova edhe më lart e kam pasur si mjet që të mbrohem në rast se më nevojitet, për arsye se ne kemi pasur një biznes në ... Republika e Sërbisë, udhëtoj, më vjen keq, kërkojë një dënim sa më të lehtë.

Prokurori i Shtetit dhe i akuzuari nuk kanë pasur propozime apo plotësime në këtë çështje penale dhe pasi që Gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë për veprën penale nga i akuzuari dhe më qenë se nga palët nuk ka pasur propozime të reja për plotësimin e procedurës, Kryetari trupit gjykues e ka shpallur përfundimin e shqyrtimit dhe i ka njoftuar palët se gjykata do të vazhdojë në mbështetje të nenit 248 par.4 të KPP-së me shqiptimin e dënimit – respektivisht me shpalljen publike të aktgjykimit, e cila shpallja e aktgjykimit është bërë me dt.17.11.2020, shpallja ka qenë e hapur dhe publike në respektim të masave anti Covid-19, në prezencë të të akuzuarit ndërsa në mungesë të Prokurorit të Shtetit.

Në lidhshmëri të pranimit të fajësisë nga i akuzuari në vlerësimin dhe analizimin e provave materiale që janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale dhe në mbështetje të nenit 361 të KPP-së, gjykata vërtetoj se ekzistojnë prova materiale se në veprimet e të akuzuarit kemi të bëjmë me elementet e veprës penale *Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së*, me të cilën akuzohet sipas aktakuzës, kjo konstatohet nga provat që janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale të cilat gjenden në shkresat e lëndës: Raporti fillestar i incidentit me nr.2018-BC-1014 i dt.11.11.2018, Procesverbali mbi marrjen në pyetje të të dyshuarit I.G në Polici me dt.11.11.2018, Vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve me nr.2018-BC-1014 i dt.11.11.2018, andaj të gjitha këto vërtetojnë rrethanat për gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe me këto veprime përmbushen-krijohen elementet e veprës penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së*, të gjitha rrethanat si me lart tregojnë gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

Duke vlerësuar përgjegjësinë penale të të akuzuarit në rastin konkret në raport me çështjen penale ndaj të akuzuarit nuk ekzistojnë rrethana të cilat kishin me përjashtuar përgjegjësin penale të të akuzuarit në këtë çështje.

2019:186386

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartësisë së dënimit për të akuzuarin gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, Gjykata si rrethanë lehtësuese vlerësoj pranimin e fajësisë nga i akuzuarit, shprehjen e keqardhjes dhe pendimin e shprehur nga i akuzuari për kryerjen e veprës penale, mbi bazën e këtyre rrethanave të përcaktuara si më lart, Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale me të cilën akuzohet i akuzuari dhe se Gjykata ka vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllim i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, se i akuzuari në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e paligjshme dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata si nën pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit, të akuzuarit i ka shqiptuar edhe dënimin plotësues konfiskimin e sendit - bocës me sprej (OS) ngjyrë e gjelbërt, "American Style NATO", të cilën e ka pasur në posedim i akuzuari në kundërshtim ligjor me nenin 4 par.1 pika 1.1 nën pika 1.1.2 të Ligjit për Armët (Ligji Nr.05/L-022), Gjykata duke marrë për baze sigurinë juridike po ashtu është sende që është rezultat i kryerjes së veprës penale siç vërtetohet me lart, kjo në mbështetje të nenit 282 par.1 e lidhur me par.2 nën par.2.1 të KPP-së, pasuria që është qenësisht e paligjshme i nënshtrohet automatikisht konfiskimit pa marrë parasysh gjetjet e gjykatës lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit, e lidhur me nenin 374 par.3 të KPRK-së, përcakton "Arma në pronësi, kontroll apo posedim në kundërshtim të këtij neni konfiskohet", andaj për shkaqe ligjore të konstatuara me lart gjykata ka vendos si nën pikën II të këtij Aktgjykimi, që sendet e përdorura të merren –konfiskohen.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 450, 451 dhe 453 të KPP-së, ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit në mbështetje të nenit 39 par.3 nën par.3.2 të Ligjit nr.05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga të cekurat si më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.165/2020 dt.19.11.2020

Procesmbajtësi
Endrit Hajrizaj

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Bekim Veliqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

2019:186386